

VENDIM
Nr.56, datë 3.8.2009

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË RREGULLAT E TREGUT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s dhe vendimit nr.68, datë 23.6.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, pika XIX.1.1, vendimit nr.39, datë 18.5.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për fillimin e procedurave për disa ndryshime dhe shtesa në rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.8.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga OST sh.a. për ndërhyrjen në dispozitat e rregullave të tregut që lidhen me rregullat për alokimin e kapacitetit të interkonjeksionit,

VENDOSI:

1. Në rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin nr.68, datë 23.6.2008, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa si më poshtë:

Pika X.1.2 riformulohet:

“Të drejtat e siguruara – OST-ja do t’i rezervojë një kapacitet specifik prej 25% furnizuesit publik me shumicë dhe prej 50% për OSSH-në.

Këto të drejta të siguruara për interkonjeksion janë vetëm për importin. Kërkesat për kapacitet interkoneksioni për qëllim tranzitimi do të merren në konsideratë nga ana e OST-së, vetëm pas plotësimit të kërkesave për importin e energjisë elektrike për nevojat e konsumatorëve tariforë dhe atyre të kualifikuar, si dhe mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes.

ERE-ja mund të rishikojë dhe modifikojë të drejtat e siguruara sipas këtij paragrafi brenda muajit nëntor të çdo viti.”.

Në pikën X.1.3 fjalia “Të drejtat ndahen për çdo interkonjeksion si për importin, ashtu edhe për eksportin dhe gjithashtu mund të tregtohen mes pjesëmarrësve”, ndryshohet si vijon:

“Të drejtat e interkonjeksionit mund të tregtohen mes pjesëmarrësve.”

2. Ngarkohen përgjegjësit e tregut për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta